



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____ /2015

**“PËR
DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008 ‘PËR
TAKSAT KOMBËTARE’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve: 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
“5. “Automjet luksoz” konsiderohet autovetura deri ne 4+1, me cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm³.”.

Neni 2

Në nenin 3, pas pikës 10, shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11. Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze.”.

Neni 3

Në nenin 4 pika 4, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Fjalja e parë e paragrafit të parë të pikës 4, të nenit 4 ndryshon si më poshtë:
“4. Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.”

2. Fjalja e parë e paragrafi të tretë të pikës 4, në nenin 4, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar sasinë e shitjes me shumicë të produktit me nivelin e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji”.

3. Fjalja e dytë e paragrafit të katërt të pikës 4, të nenit 4, ndryshon me këtë përmbajtje:

“Masa e rentës minerare, e përcaktuar në ligjin minerar, ndryshon sipas paragrafëve të parë dhe të dytë, të pikës 4, të nenit 4 të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 4 pika 5, ndryshon me këtë përmbajtje:

“5. Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas Shtojcën nr.3, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Neni 5

Në nenin 4, pika 9, ndryshohet si më poshtë:

“9. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 10 për qind e shumë së primit.”.

Neni 6

Pas pikës 10 të nenit 4, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

“11. Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore e mjeteve të përdorura , për automjetet luksoze zbatohet:

1. taksë regjistrimi fillestar në masën 70,000 (shtatëdhjetë mijë) lekë; dhe
2. taksë vjetore e përvitshme në masën 21,000 (njëzet e një mijë) lekë

Në kuptim të këtij ligji, automjet luksoz konsiderohet autovetura deri në 4+1, me cilindratinë të barabartë ose më të madhe se 3000 cm³.”

Neni 7

Në nenin 5 “Agjentët e taksave” pas shkronjës g), shtohet shkronja gj) me këtë përmbajtje:

“gj) Për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

Neni 8

Në nenin 8 “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave “ pas shkronjës f), shtohet shkronja g) me këtë përmbajtje:

“g) Për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze, zero për qind.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi më datën 1 janar 2016 dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R

ILIR META

SHTOJCA NR.2 PËRQINDJA E RENTËS MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT

Nr.	Emërtimi i grupit të mineraleve sipas ligjit minerar	Përqindja e rentës minerare
Grupi i parë (I) MINERALET METALIKE		
1	Mineralet e Argjendit	10 % e çmimit të shitjes
2	Mineralet e Arit	10 % e çmimit të shitjes
3	Mineralet e Bakrit	6% e çmimit të shitjes
4	Mineralet e Kromit	6% e çmimit të shitjes
5	Mineralet e Nikelit (nikel-silikat)	6% e çmimit të shitjes
6	Mineralet e Hekurit (hekur-nikeli)	5% e çmimit të shitjes
7	Mineralet Plumbit	5% e çmimit të shitjes
8	Mineralet e Zinkut	7% e çmimit të shitjes
9	Gjithë mineralet e tjera metalike	4% e çmimit të shitjes
Grupi i dytë (II) MINERALET JOMETALIKE		
10	Të gjitha mineralet jometalike	4 % e çmimit të shitjes
Grupi i tretë (III) QYMYRET DHE BITUMET		
11	Qymyret	19,940 lekë/ton
12	Bitumet	2,371 lekë/ton
13	Rërat bituminoze	117 lekë/m ³
14	Reshpet naftore	117 lekë/m ³
15	Pirobitumet	2,371 lekë/ton
16	Qymyr guri	200 lekë/ton
Grupi i katërt (IV) MINERALET DHE MATERIALET E NDËRTIMIT		
17	Graniti	5,850 lekë/m ³
18	Gëlqerorët	47 lekë/m ³

19	Gabrot	47 lekë/m ³
20	Bazaltet	73 lekë/ton
21	Konglomerate	
22	Mermeri	4,095 lekë/m ³
23	Pllakat e ndërtimit	
23.1	<i>Pllaka guri</i>	228 lekë/m ³
23.2	<i>Pllaka ranore</i>	1,456 lekë/m ³
23.3	<i>Pllaka graniti</i>	6,825 lekë/m ³
23.4	<i>Pllaka mermeri</i>	4,550 lekë/m ³
23.5	<i>Pllaka të tjera</i>	6,000 lekë/ton
24	Pllagjiogranitet	5%
25	Ranoret	491 lekë/m ³
26	Serpentinitet	47 lekë/m ³
27	Travertinat	2,925 lekë/m ³
28	Traktolitet	2,925 lekë/m ³
29	Gips	21 lekë /ton
30	Alabastër	423 lekë/m ³
31	Argjila (prodhim çimento,tjegulla, tulla, etj)	15 lek/ton
32	Argjila (prodhim diga hidrocentrali)	104 lekë/m ³
33	Argjil (për prodhim qeramike)	23 lekë/ton
34	Rërë lumi	98 lekë/m ³
35	Inerte lumore	42 lekë/m ³
36	Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt	104 lekë/m ³
Grupi i pestë (V) GURËT E ÇMUAR		
37	Gjithë mineralet e grupit të pestë	10% e çmimit të shitjes
Grupi i gjashtë (VI) GURËT GJYSMË TË ÇMUAR DHE OPALI		
38	Gjithë mineralet e grupit të gjashtë	10 % e çmimit të shitjes
39	Grupi i shtatë (VII)	10 % e çmimit të shitjes

SHTOJCA NR. 3: TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

MASA E TAKSËS

- | | |
|---|------------|
| 1. Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit | 50 lekë |
| 2. Për lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja | 200 lekë |
| 3. Për regjistrimin e shtetasve të huaj pas dhënies së shtetësisë shqiptare | 2 000 lekë |
| 4. Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit | 1 000 lekë |
| 5. Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës | 1 000 lekë |
| 6. Për procedurën për veçim/bashkime familjeje | 1 000 lekë |

